



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

**PROJEKT – REZOLUTË
PËR ÇELJEN E NEGOCIATAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR
ANËTARËSIMIN NË BASHKIMIN EUROPIAN.**

- Në zbatim të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 15/2015, “Për rolin e Kuvendit në procesin e integritit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Evropian”, të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë dhe duke marrë në konsideratë rolin e Kuvendit, si organi më i lartë ligjbërës dhe kontrollues;
- Duke riafirmuar se objektivi strategjik i Republikës së Shqipërisë është anëtarësimi në Bashkimin Evropian, me mirënjohje për mbështetjen e vazhdueshme që Bashkimi Evropian dhe shtetet e tij anëtare i kanë dhënë Shqipërisë në përmbushje të reformave për procesin e integritit evropian;
- Duke riafirmuar mbështetjen e palëkundur për të respektuar vlerat e sanksionuara në traktatet e Bashkimi Evropian dhe vendosmërinë për zhvillimin e një shoqërie demokratike, bazuar në sundimin e ligjit, respektin për të drejtat e njeriut dhe parimet e ekonomisë së tregut;
- Duke marrë në konsideratë faktin se dialogu gjithëpërfshirja dhe transparenca, të mbështetura në parimet demokratike dhe institucionet kushtetuese janë thelbësore për progresin e qëndrueshëm të institucioneve të Shqipërisë në procesin e integritit evropian;
- Duke marrë në konsideratë reformat e ndërmarra në kuadër të procesit të integritit evropian dhe përparimin e bërë nga Shqipëria në plotësimin e rekomandimeve kyçe të Komisionit Evropian dhe zbatimin e qëndrueshëm të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ku në veçanti janë përparësitë e vendosura nga Komisioni Evropian si kusht paraprak për çeljen e negociatave;
- Duke marrë në konsideratë raportin e fundit të OSBE/ODIHR dhe duke konsideruar themelore reformën zgjedhore dhe zbatimin e rekomandimeve të raportit të mësipërm sipas parimeve demokratike dhe brënda kuadrit kushtetues dhe institucional;
- Duke theksuar rëndësinë e forcimit të mëtejshëm të përfshirjes dhe rolit të shoqërisë civile në procesin integruar të vendit me qëllim forcimin e dialogut gjithëpërfshirës dhe rritjen e transparencës në procesin e integritit evropian;
- Duke theksuar synimin për forcimin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të aktiviteteve të organeve, nëpërmjet të cilave Kuvendi ushtron përgjegjësinë e tij në procesin e integritit evropian,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË:

1. Vlerëson Raportin e Komisionit Europian të datës 29.05.2019 dhe rekomandimet e tij për reformat e mëtejshme në kuadër të procesit të integrimit europian;
2. Vlerëson rolin e tij në drejtim të zhvillimit të dialogut gjithëpërfshirës, mbështetur në parimet demokratike, brenda kuadrit kushtetues dhe institucional mbi çështjet e integrimit europian;
3. Inkurajon forcimin e mëtejshëm të rolit të tij në mbikqyrje të reformave integruese të vendit;
4. Thekson se angazhimi i qëndrueshëm institucional për përmbushjen e rekomandimeve të Komisionit Evropian dhe përfundimeve të Këshillit Europian përbën përparësinë kryesore të punës së Kuvendit të Shqipërisë;
5. Mbështetet Reformën në Drejtësi si një reformë kyçe dhe një reforme shumë e rëndësishme për qytetarët e Shqipërisë si dhe Inkurajon institucionet kompetente për ngritjen e organeve të reja të reformës në Drejtësi si Prokurorinë Speciale Kundër Korrupsionit (SPAK), Byronë Kombëtare të Hetimit (BKH) si dhe Gjykatën Kushtetuese;
6. Kërkon nga organet ligjzbatuese rezultate konkrete dhe të vazhdueshme në luftën kundër korrupsionit, krimit të organizuar dhe të drejtave të njeriut
7. Shpreh vullnet të plotë për të ecur në rrugën e reformave në frymën e mirëkuptimit ndërpartiak dhe në bashkëpunim të plotë me shoqërinë civile;
8. Shpreh vullnet të plotë për të çuar përpara reformën për garantimin e zgjedhjeve të lira dhe të ndershme, sipas parimeve demokratike dhe standarteve ndërkombëtare, në interes të qytetarëve shqiptarë;
9. Shpreh angazhim të plotë për mbikqyrjen e përparësive të vendosura nga Komisioni Europian si kusht për çeljen e negociatave dhe nxitjen e Qeverisë për zbatimin e këtyre përparësive;
10. Duke kondideruar që anëtarësimi i Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian tejkalon çdo interes partiak pasi mbështetet nga gati tërësia e qytetarëve shqiptarë, inkurajojmë vendet anëtare të Bashkimit Europian që në takimin e ardhshëm të Këshillit Europian të shprehin vullnetin e tyre për çeljen e negociatave të Republikës së Shqipërisë me Bashkimin Europian.

Miratuar në datën . .2019

KRYETARI

Gramoz RUÇI